REPUBLIKA E KOSOVËS-Republika Kosova-Republic of Kosovo
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.
Org.Jedinica 01
Org Unit
Nr.Prot:
Br.oj Prot.
Prot.No 05-6936
Nr.i faqeve
Br.stranica -2-
No.pages
Data:
Datum:
Date: 02/10/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 209/X /2026
Datë: 01/10/2026

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 7, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale, bazuar në propozimin e Komisionit për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, të përcjellë me shkresën nr. prot. 05-6885, datë 29.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shpallet afati për aplikim për rideklarimin e çmimeve të produkteve medicinale nga bartësit e autorizimit për marketing ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar për vitin 2027, **nga data 02 tetor 2026 deri më 15 tetor 2026**, përmes sistemit elektronik "Barnatari", për produktet medicinale **të regjistruara në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM)**, çmimet e të cilave janë përcaktuar dhe janë në fuqi gjatë vitit 2026.

2. Obligohet Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale për zbatimin e këtij vendimi dhe për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Shtojca 1 është pjesë e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë

Vendimi i dërgohet:
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Z. Edon Muçaj – Kryesues i Komisionit*
- *AKPPM;*
- *Divizionit të Farmacisë;*
- *Arkivit të MSH-së.*

Shtojca 1 - Dokumentacioni i nevojshëm për rideklarimin e çmimeve

1.Bartësi i Autorizimit për Marketing në Kosovë, apo përfaqësuesi i autorizuar nga Bartësi i Autorizimit për Marketingut (në tekstin e mëtejmë: aplikuesi), për rideklarimin e çmimeve të produkteve medicinale aplikon përmes sistemit elektronik "Barnatari", duke bashkëngjitur dokumentacionin përcjellës, si në vijim:

1.1. Letër përcjellëse nga Bartësi i Autorizimit për Marketing (BAM);

1.2. Autorizimi për deklarimin e çmimit nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për aplikuesin, në rastet kur aplikuesi është përfaqësues i autorizuar;

1.3. Certifikata e Autorizimit për Marketing (kur është e aplikueshme);

1.4. Dëshmi mbi çmimin e importit;

1.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinatore.